V E N D I M
Nr.133, datë 13.4.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.317, DATË 8.7.1999, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPËRBLIMIN E PUNËS SË PUNONJËSVE", NDRYSHUAR ME VENDIMET NR.261, DATË 25.5.2000 DHE NR.36, DATË 20.1.2001

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 dhe 6, të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.317, datë 8.7.1999, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1.Paragrafi i tretë i pikës 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

"Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme deri në 1:7, por jo më shumë se paga e kategorisë II-b, e lidhjes nr.1, e vendimit nr.711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunëse civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndryshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

Për ndërmarrjet e mëdha dhe strategjike, jo më e lartë se paga e kategorisë I-b, e lidhjes nr.1, e vendimit nr.711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Ministrave, "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe Kuvendit dhe disa shtesa e ndyshime në vendimin nr.726, datë 21.12.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore".

2.Në pikën 8, shprehja "me klasifikimin A9, të miratuar me vendimin nr.393, datë 3.9.1992, të Këshillit të Ministrave,. "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", zëvendësohet me shprehjen:

"me kategorinë I-b, të lidhjes nr.1, të miratuar me vendimin nr.711, datë 27,12,2001, të Këshillit të Ministrave".

Ky vendim hyn në fudi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko